

**LIGJ**  
**Nr.8280, datë 15.1.1998**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8043, DATË 30.11.1995 “PËR KONTROLLIN E FIGURËS SË ZYRTARËVE DHE PERSONAVE TË TJERË QË LIDHEN ME MBROJTJEN E SHTETIT DEMOKRATIK”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8151, DATË 12.9.1996, NR.8220, DATË 13.5.1997 DHE NR.8232, DATË 19.8.1997**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e një grupi deputetësh,

**KUENDI POPULLOR**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**Neni 1**

Në ligjin nr.8043, datë 30.11.1995 “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik”, ndryshuar me ligjin nr.8151, datë 12.9.1996, nr.8220, datë 13.5.1997 dhe nr.8232, datë 19.8.1997, bëhen këto ndryshime:

Neni 2 ndryshohet si vijon:

“Emërimi apo zgjedhja e kandidatëve në funksionet dhe organet e përmendura në nenin 1 kushtëzohet me zbatimin e kriterëve ligjore që, për periudhën 29 nëntor 1944, deri 11 dhjetor 1990, kandidati të mos ketë qënë në funksionet që vijnë:

a -Anëtar apo kandidat i Byrosë Politike të Partisë së Punës, me përjashtim të rasteve kur ka vepruar kundër vijës zyrtare, apo është larguar vetë nga detyra në mënyrë publike.

B -Të mos ketë qënë oficer madhor apo funksionar drejtues në organet e Sigurimit të Shtetit, si kryetar dege, drejtor apo zëvendësministër dhe ministër i organeve të Punëve të Brendshme.

C -Të mos ketë qënë bashkëpunor i organeve të Sigurimit të Shtetit me veprimtari të karakterit politik, që lidhen me veprat penale të parashikuara nga ligji nr.7514, datë 30.9.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe riabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë” apo bashkëpunor vullnetar për vepra të tilla, të mos ketë qënë në shërbimet e huaja të zbulimit si dhe në organet e tjera analoge.

Ç -Të mos jetë dënuar me vendim penal të formës së prerë për krime kundër njerëzimit, për shpifje apo dëshmi të rreme në procese politike; të mos ketë qënë anëtar i Komisionit Qendror të Dëbim-internimeve.”

Neni 3 ndryshohet si vijon:

“Në raste të veçanta, kur e kërkojnë interesat e shtetit, në sektorin e mbrojtjes, në atë të rendit dhe në atë të SHIK-ut, mund të mos zbatohet kushti i parashikuar në gërmat “b”, “c” dhe “ç” të nenit 2, me kusht që propozimi të jetë i arsyetuar dhe me shkrim. Propozimi i bërë nga organet e interesuara, pasi miratohet nga Kryetari i Këshillit të Ministrave, i paraqitet Komisionit për vendimin përkatës.”

Neni 5 ndryshohet si vijon:

“Veprimtaria e Komisionit legjitimohet kur vendimet e tij merren me shumicë votash dhe janë të pranishëm kryetari apo zëvendëskryetari dhe 4 anëtarë.

Kur për vendimet e marra paraqiten të dhëna të reja që hedhin dritë mbi të vërtetën, Komisioni mund të bëjë rishikimin e vendimit. Rishikim të vendimeve mund të bëhen edhe me kërkesën e Presidentit të Republikës, të Kryetarit të Kuvendit Popullor, të Kryetarit të Këshillit të Ministrave dhe të kryesive të subjekteve politike.”

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi ditën e shpalljes nga Presidenti i Republikës.

**Shpallur me dekretin nr.1994, datë 22.1. 1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**